REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 14/17
Datë/Datum. 06.02.2017
PRISHTINË - PRIŠTINA

Republika e Kosovës

Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

AKT PËRCJELLËS

DATË/A:	**06.02.2017**
REFERENCË:	
PËR/ZA/TO:	Menaxherin e prokurimit, **Korporata Energjetike e Kosovës**
CC:	- Paneli Shqyrtues – **OSHP, Nr.14/17** - OE "DWH-KOSOVA" me seli në Prishtinë
NËPËRMJET/PREKO/THROUGH	
NGA/OD/FROM:	Muhamet Kurtishaj - **Ekspert Shqyrtues/teknik**
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	**"Furnizim me GPS dhe Stacion Total " Lot 1 dhe Lot 2 me nr. prokurimi KEKO 16/441/121**

Bazuar në nenin 113 dhe 114 të LPP-së ju njoftojmë me ekspertizën e lëndës lidhur me aktivitetin e **"Furnizim me GPS dhe Stacion Total " Lot 1 dhe Lot 2 me nr. prokurimi KEKO 16/441/121** të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – **Korporata Energjetike e Kosovës** dhe me përgjigjeje ndaj ankesës së operatorit ekonomik **"DWH-KOSOVA"** me nr.**14/17** të datës **17.01.2017.**

Konform nenit 113 dhe 114, Pjesa IX e LPP-së, Eksperti Shqyrtues i pavarur, ka shqyrtuar dhe analizuar procesin e prokurimit në fjalë, dhe ka konstatuar si më poshtë.

AK është i thirrur që pas marrjes së raportit të ekspertit shqyrtues lidhur më këtë procedurë të prokurimit përkatësisht pretendimeve të bëra në ankesë, të veprojnë sipas kërkesave të nenit 115 të LPP-së.

	31.01.2017		01.02.2017		06.02.2017
Nënshkrimi i ekspertit	Data e pranimit të autorizimit		data e fillimit të ekspertizës		data e dorëzimit të raportit

N. 99, LPP - Baza ligjore e shqyrtimit-

Me datë **17.01.2017** Organi Shqyrtues i Prokurimit, ka pranuar ankesat me numër të protokollit **14/17** e parashtruar nga operatori ekonomik **"DWH-KOSOVA"** me seli në Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit **"Furnizim me GPS dhe Stacion Total " Lot 1 dhe Lot 2 me nr. prokurimi KEKO 16/441/121** të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – **Korporata Energjetike e Kosovës.**

Konform nenit 113 dhe 114, Pjesa IX e LPP-së, Eksperti Shqyrtues/teknik e ka shqyrtuar dhe analizuar procesin e prokurimit në fjalë si më poshtë:

N. 111,-*Operatori Ekonomik Ankues* "DWH-KOSOVA" me seli në Prishtinë

Pikat e Ankesës:

Është shkel neni 7 i LPP-së (Barazia në Trajtim /jo/Diskriminimi)
Është shkel neni 28 i LPP-së (Specifikimet teknike)
Është shkel neni 58 i LPP-së (Hapja e Tendereve)
Është shkel neni 108A i LPP-së (Zgjidhja preliminare e mosmarrveshjeve)

Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Ne kemi bërë këto pyetje:

Pyetje per LOT 1

1. Cilet duhet te jene protokollet e komunikimit ne Refnet (KOPOS):

iMAX po apo jo (ky format ofrohet nga KOPOS dhe jep saktesi maksimale dhe konstante)
MAC po apo jo (ky format afrohet nga KOPOS dhe jep saktesi maksimale dhe konstante)
VRS po apo jo (ky format ofrohet nga KOPOS por jep saktesi variable, jo konstante)
FKP po apo jo (ky format perdoret me rralle)

Pytja 1 nuk kemi mar pergjigje

2. Sa duhet te jete kapja simultane e sateliteve ne dy frekuenca: 50, 55, 60 apo....?

Pytja 2 nuk kemi mar pergjigje

3. Siguria e matjes duhet te jete:
a) better than 99,95% apo
b) better than 99,99%

Pytja 3 nuk kemi mar pergjigje

4. Sa duhet te jete saktesia ne matje NetWork (KOPOS):
Hz: lOmm + 0.5ppm apo lOmm + lppm
V: 20mm + 0.5ppm ap 20mm + lppm

Pytja 4 nuk kemi mar pergjigje

5. A duhet qe UPS i ri te jete i integruar dhe **kornpatibil** me GPS eksistues:
   a) Kontrolleri i GPS te ri duhet te komunikoje me Antenen e UPS eksistues: po apo jo
   b) Kontrolleri i GPS te vjeter duhet te komunikoje me Antenen e GSP te ri po apo jo
   c) Radiomodem i GPS eksistues cluhet te komunikoje me antenen e UPS te ri: po apo jo
   d) Aksesoret (kabllot, baterite, rnbusheset, kartat etj) te GPS te ri duhet te jene integruese dhe kompatibil me GPS ekzistues: po apo jo

e) Aksesoret (kabllot, bateritet, mbusheset, kartat etj) te GPS eksistues duhet te jene integruese dhe kompatibel me GPS e ri: po apo jo?
f) Software-et aksistues duhet te jene te hapur edhe per GPS e ri: po apo jo?

Shenim: Ne kete menyre rritet vlera e investimeve paraprake dhe vlera e investimit te ri.

Pytja 5 nuk kemi mar pergjigje

6. Pika 9 kerkon qe Antena te kete memorje, por edhe terminali te kete memorje? Ne rastet e Roverit memorja ne antene eshte nje kerkese teresisht e pashfrytezuar, e cila rrit pa shkak cmimin e produktit, sepse nese te dhenat ruhen ne memorje te antenes, gjeodeti gjate matjes nuk ka akses ne te dhenat e matjes dhe nuk mund perdore aplikimet, si qe kerkohen ne piken 6 (pra nuk mund te perdore CEPS si NetRover si edhe kerkohet ne piken 1, 2, 6, dhe 10). Antena as nuk mund te vendoset fare ne pune pa kontroller. Ku eshte sensi i kesaj kerkese?
Kjo kerkese do mbetet keshtu apo do ndryshohet?

Pytja 6 nuk kemi mar pergjigje

7. Ne piken 11 kerkohet qe Antena e GPS te jete e integruar(?) Te kete porte USB dhe mini USB
   a) E integruar me cfare?
   b) Antenna eshte produkt i ekspozuar ne temperatura shume te ulta dhe shume te larta, si edhe ne kushte shiu, bore dhe lageshtie dhe nuk eshte zgjidhje profesionale qe antena te kete porta USB dhe/ose miniUSB? Ky specifikim nuk haset ne GPS profesionale e prodhuesve kryesore? Ky konfigurim haset vetem ne nje antene periferike te nje prodhuesi japonez (GCX2)

Shenim: Kjo kerkese eshte site kerkosh kerr modern me timon mekanik (pra moasarritjet teknologjike behen kerkese. Rrota historise shkon para dhe jo pas)

Pytja 7 nuk kemi mar pergjigje

8. Nuk jepet asnje tjale per kontrollerin e GPS, qe eshte edhe konvergjimi i gjithe punes me GPS.
   a) Duhet te jete 3.5G apo 3.75G
   b) Duhet te jete me Touch Screen dhe butona? Sa butona 25, 35, 45, 55 apo me shume?

Pytja 8 nuk kemi mar pergjigje

<u>Pyetje per LOT 2</u>
1. Saktesia ne distance kerkohet 5 den i 3", kurse saktesia ne distance 2mm + 2ppm, cka bie ne kundershtim me saktesine kendore. Saktesite e prodhuesve kryesore ne bote (Leica, Trimble, Spectra, GeoMax etj...bile edhe Stonex dhe Hi-Target kineze) jane **1.5mm + 2ppm,** pra behet fjale per nje kerkese qe ne start eshte **25% me e dobet.** Pyetja eshte do qendroje keshtu?

Pytja 1 nuk kemi mar pergjigje
2. Qenderzimi i stacionit total duhet te jete me laser (i painfluencueshem nga njeriu) apo pa laser (cka nuk e kufizon faktorin njeri)

Pytja 2 nuk kemi mar pergjigje
3. A duhet te jete stacioni total Ilicomatj120. me GPS (si software dhe logjike, cka lejon qe te kalohet nga matjete ne UPS ne stacion total dhe anasjelltash pa bere asnje ncierhyrje?

Pytja 3 nuk kemi mar pergjigje
4. A duliet qe stacioni total te jete **<u>kompatibel</u>** me stacionet totale eksistues ne KEK po apo jo?

Pytja 4 nuk kemii mar pergjigje

5. A duhet qe stacioni total te jete **kompatibel** me UPS eksistues ne KEK (si ne software dhe aksesore)?

Pytja 5 nuk kemi mar pergjigje

6. A duhet qe stacioni total te jete i afte te suportoje GPS eskistues duke u kthyer ne SmartStation (pra stacioni Total kthehet ne GPS)?

Pytja 6 nuk kemi mar pergjigje

7. A duhet qe Stacioni Total te jete me Image (cka lejon qe matjet e pabere ne terren te perftohen ne zyre me saktesine e kerkuar) dhe qe lejon matje ne pika te paarritshme qe me heren e pare?

   Ne si operatore ekonomik qe kemi pasur ne vazhdimesi mardhenie kontraktuale me KEK-un, ju informojme se Specifikimi Teknik momental eshte i demshem per AK. Pasi qe investimet e deritanishme jo qe avancohen por thuase dalin nga perdorimi, ndersa nese pergjegjet tuaja jane pozitive ne pyetjet tona , aseteve te meparshme i ngritet vlera. Me kompatibilitet behet edhe Avancimi.

Pytja 7 nuk kemi mar pergjigje

Ne kemi bere 15 pyetje dhe nuk kemi mar asnje pergjigje

Dëmet Materiale

Tenderi nuk është përfunduar.

Propozim

Ne kërkojm rishqyrtim të të gjitha kërkesave teknike.

Procesi i prokurimit

Data e njoftimit për kontratë(N.40) :	19.12.2016
Lloji i procedurës së aplikuar (N.32-35):-	Procedurë e hapur
Lloji dhe vlera e kontratës së publikuar(N.16):	Furnizim/e mesme
Afati i fundit për dorëzimin e ofertave (gjithsejtë ditë):	10.01.2017 ora 13ºº
Data e hapjes së ofertave (N.58) -	**.nuk eshte bere hapja** 10.01.2017 ora 13ºº
Data e njoftimit për dhënie te kontratës	***nuk është bërë.***

III.2 KUSHTET PËR PJESMARRJE

III.2.1- Kërkesat e përshtatshmërisë:

Kërkesat e përshtatshmërisë:

- Operatori Ekonomik duhet të përmbushë kërkesat e specifikuara në nenin 65 të Ligjit të Prokurimit Publik (LPP),

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

1. Deklaratat nën betim se operatori ekonomik përmbush kërkesat mbi përshtatshmërinë të LPP-se, Neni 65, siç është e cekur ne piken a deri ne i do të dorëzohen në formë të Aneksit
2. Një vërtetim i lëshuar nga gjykata kompetente apo autoritetet administrative të vendit të themelimit të tenderuesitper piken j deri ne q .
3. Një vërtetim i nënshkruar nga Administrata tatimore e vendit të themelimit të Operatorit ekonomik, se Operatori ekonomik në fjalë nuk është me vonesë ne pagimin e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit të vitit para dorëzimit të tenderit.

Për piken 2 dhe 3 kërkohet vetëm nga Operatori ekonomik qe propozohet për dhënien e kontratës.

III.2.2 Përshtatshmëria profesionale *Kërkesa:*

Kërkesa:

1. Regjistrimi si operator ekonomik në regjistrin profesional, komercial dhe/apo regjistrin e ndërmarrjeve në vendin e juaj të themelimit;
2. Regjistrimi i TVSH;
3. Regjistrimi i numrit fiskal;

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

1. Një dokument i lëshuar nga autoriteti përkatës publik në vendin e themelimit të operatorit ekonomik me të cilin evidentohet regjistrimi i operatorit ekonomik në atë vend (Kopja e çertifikatës së biznesit);
2. Kopja e TVSH-se;
3. Kopja e numrit fiscal

III.2.3 Kapaciteti ekonomik dhe financiar

N/A

III.2.4 Kapaciteti teknik dhe profesional

Kërkesat:

1. *Autenticitetit i produkteve dhe cilësisë*
2. *Katalogët te produkteve*
3. *Certifikatë të produkteve në lidhje me përshtatjen dhe specifikat ose standardet*

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

1. *Autorizimi nga prodhuesi ose nga distributori i autorizuar (të bashkangjitur kopja e marrëveshjes e distributorit me prodhuesin), për shitjen e produkteve qe ofroni. (PER LOT 1)*
2. Katalog ose pjesë të katalogut me përshkrimin detal për produktin te ofertuar
3. *Kopja e Certifikates se ISO Standardit 9001:2008 e prodhuesit (PER LOT 1)*

Regjistri i ofertuesve sipas procesverbalit të hapjes publike (N.58):

Nuk është bërë

Kriteret për vlerësim

Kriteri për dhënien e kontratës (N.60):..... Tenderi i përgjegjshëm **Çmimi më i Ulët**

Komisioni vlerësimit pranë AK

Nuk është formuar

Raporti i komisionit vlerësues

Nuk ka

Rishqyrtimi i kërkesës nga Autoriteti Kontraktues

E datën 06.01.2017, autoriteti kontraktues ka pranuar kërkesën për rishqyrtim të parastruar nga OE **"DWH-KOSOVA"** lidhur me aktivitetin e prokurimit **"Furnizim me GPS dhe Stacion Total " Lot 1 dhe Lot 2 me nr. prokurimi KEKO 16/441/121.** Me datën 12.01.2017 lidhur me kete kërkesë Autoriteti kontraktues mori këtë:

Vendim

Refuzohet si e pa bazuar kërkesa e paraqitur për rishqyrtim nga OE **"DWH-KOSOVA"** lidhur me aktivitetin e prokurimit **"Furnizim me GPS dhe Stacion Total " Lot 1 dhe Lot 2 me nr. prokurimi KEKO 16/441/121.**

Analiza dhe konstatimet e ekspertit shqyrtues (N. 113,114)

Në finalizim të analizimit dhe shqyrtimit të Lëndës së Tenderit për këtë aktivitet të prokurimit, bazuar në dokumentacionin që ka pasur në dispozicion eksperti shqyrtues-teknik jep mendimin si në vijim:

Konstatimi: Nr. 1

Ky aktivitet i prokurimit është i publikuar nga autoriteti kontraktues me procedurë të hapur. Lloji i kontratës është furnizim, kontratë publike me vlere te mesme. Lidhur me kete aktivitet te prokurimit Operatori ekonomik ankues gjatë fazës për marrjen e dosjes së tenderit ka kërkuar informacione shtesë nga autoriteti kontraktues.

Per këto informacione shtesë, OE ankues ka marrë disa përgjigjëje nga autoriteti kontraktues, OE ankues thekson ne ankesë se për pjesën teknike nuk ka marre pergjigjeje.
Ne shenje ta paknaqesise me pergjigjejet e marra prej autoriteti kontraktue, OE ankues ka bere kerkese per Ri shqyrtim dhe pas pergjigjejes qe ka marre nga AK, atehere ka dorezuar ankesen ne OSHP.

Konstatimi nr. 2

Gjatë shqyrtimit të kësaj lënde, Eksperti shqyrtues/teknik në përputhje me nenin 113 pika 1 të LPP-së, jep mendimin për pretendimet ankimore të OE ankues si në vijim:

Pretendimi i OE ankues se ne kete aktivitet te prokurimit autoriteti kontraktues ka bere shkelje te nenit te 7 te LPP-se(Barazia ne trajtim/jo diskriminimi) sepse nuk ka dhene informacione per kerkesat e OE, per mendimin e ekspertit teknik eshte pretendim i **pa bazuar**.
Nuk ka pasur diskriminim ose favorizim ne kete faze te aktivitetit te prokurimi për ndonjë OE qe ka marre dosjen e tenderit. Specifikimi teknik eshte i njejte per te gjithe OE. Nuk ka pas ankese nga ndonjë OE tjetër për specifikim teknik, përveç OE ankues ne fjale. Autoriteti kontraktues ka dhene pergjigjeje sqarues ne pyetjet e derguar nga OE ankues per te cilat AK ka vlerësuar se ka pasur nevoje te jepen sqarime.

Konstatimi nr.3

Pretendimi tjeter i operatorit ekonomik ankues se autoriteti kontraktues ka shkelur nenin 28 te LPP-se (Specifikimet teknike), respektivisht piken 2 dhe 7 te ketij neni duke aluduar se keto dy pika ndalojn pershtatjen e specifikimit teknik ne OE ose nje prodhuesi te caktuar,per mendimin e ekspertit teknik eshte po ashtu pretendim i **pa bazuar**.
Sipas specifikimit teknik ne dosjen e tenderit nuk verehet askund se ka ndonje element teknik qe ju ka pershtatur apo eshte favorizuar nje OE i caktuar ose ndonje prodhues konkret. Po ashtu, as OE ankues nuk e permed ne ankesen e tije se specifikimi teknik i referohet këtij apo atij prodhuesi, apo i është përshtatur një prodhuesi konkret. Përkundrazi, specifikimi teknik ne formën si është paraqitur ne dosjen e tenderit është mjaft i qarte dhe jep mundësi te ofertimit për shume prodhues.

Konstatimi nr.4

Pretendimi i OE ankues se autoriteti kontraktues ka shkel nenin 58 te LPP-se(hapja e ofertave) sidomos pika 1 sepse kjo pikë mundëson vazhdimin e afatit per hapjen e tenderit per mednimin e ekspertit teknik eshte pretendim i **pa bazuar**.
Si ka mundur te shkelet ky nen kur ende nuk eshte bere hapja e oferta pra ende nuk ka ndodhe veprimi. Ky nen qe i referohet OE ankues nuk mundëson vazhdimin e afatit per hapjen e tenderit por thote:
*"**nese** AK ne perputhshmeri me kete ligj e nxjerr nje dokument per zgjatjen e afatit, atehere ne ate dokument duhet te specifikohet afati i ri per hapjen e ofertave".*

Vazhdimi i afatit per hapjen e tenderit specifikohet me pikat 7,8 dhe 9 nenit 53 te LPP-se(Sigurimi i informatave

shtese per kandidatet dhe tenderuesit) e jo me nenin 58 te LPP-se.
Konstatimi nr.5

Pretendimi i fuendit i OE se autoriteti kontraktues ka bere shkelje te nenit 108/A te LPP-se(Zgjidhja preliminare e mosmarveshjeve) sepse ky nen mundëson paraqitje te kërkesës për rishqyrtim pranë autoriteti kontraktues per mednimin e ekspertit shqyrtues/teknik po ashtu është i **pa bazuar**.

Autoriteti kontraktues ka respektuar kete nen sepse ka pranuar kerkesen per rishqyrtim te OE ankues, ka shqyrtuar kerkesen dhe e ka refuzuar ate. Pra eshte e drejte ligjore e autoriteti kontraktues qe kerkesat per rishqyrtimi ti aprovoj ose refuzoj, varesisht si e vleresojn ata.

Shkeljet e konstatuara të LPP-së

Nuk janë vërejtur shkelje të cilat e dëmtojn procesin e prokurimit.

Përgjigje në pikat e ankesës

Përgjigjeje për pikat e ankesës janë dhënë në konstatimet e lartshënuara.

Mendimi i Ekspertit Shqyrtues/teknik

Autoriteti kontraktues ju ka pergjigjur me shkrim OE ankues lidhur me pyetjet sqaruese per tenderin ne fjale. OE ankues eshte pajtuar kryesisht me pergjigjejet e AK te dhene per pyetjet ne pjesen administrative, mirepo nuk eshte pajtuar me pergjigjet e AK per pytjet ne pjesen teknike. Pergjigjea e AK ne pjesen teknike ka qene e shkurter duke thene:
"Te gjitha te dhenat ne kerkesen per furnizim te GPS dhe ST jane te mjaftueshme dhe shume te kjarta per pjesmarrje ne tender. Çdo OE qe ofron me shume se ne kerkojme eshte i mireseardhur. Perndryshe kerkesat dhe karakteristikat tona ne specifikimin teknik te DT jane te mjaftueshme per nevojat tona".

Eksperti shqytues/teknik mendon se autoriteti kontraktues ka vepruar ne përputhje me nenin 53 te LPP-se pika 5 qe thotë:
*" nëse AK konstaton se OE **nuk kan nevoje** per informatat e kerkuara munden ta **refuzoj** kërkesën për sqarim".*

Pra autoriteti kontraktues ne kuadër te kësaj dispozite ka vlerësuar se **nuk ka nevoje** per sqarimet lidhur me pjesen teknike qe OE ankues ia ka paraqitur ne pyetjet sqaruese dhe për këtë është njoftuar OE ankues. Ndërsa autoriteti kontraktues ka dhënë përgjigjeje për pyetjet e pjese administrative sipas nenin 53 te LPP-se pika 6 dhe per kete i ka njoftuar me shkrim te gjithe OE qe e kane marre dosjen e tenderit. Pra nga autoriteti kontraktues eshte respektuar ne plotni nenit 53 i LPP-se(Sigurimi i informatave shtese per kandidatet dhe tenderuesit).

Eksperti shqyrtues-teknik e vlerëson si të **pa bazuar** ankesen e operatorit ekonomik ankues **"DWH-KOSOVA"** Prandaj në përputhje me nenin 114 pika 2 të LPP-së, rekomandon që autoriteti kontraktues – **Korporata Energjetike e Kosovës,** ta **vazhdoj** me procedure te rregullt aktivitetin e prokurimit **"Furnizim me GPS dhe Stacion Total " Lot 1 dhe Lot 2** me nr. prokurimi KEKO 16/441/121 konform dispozitave LPP-së.